



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 42, datë 05.10.2023

PËR

REFUZIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS
KANALIZIME ELBASAN SH.A PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (*ligji nr. 8102*), dhe nenit 8, 10, 13 të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime" (*Vendim KKRR nr. 539*), Vendimit të KKRR nr. 32, datë 13.09.2023 "Për një ndryshim në vendimin e KKRR Nr. 28, datë 23.06.2023 "Për shtyrje afati të aplikimit nga shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime për tarifa të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura për vitin 2023" (*Vendim KKRR nr. 32*),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 05.10.2023, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe Konsumatorit mbi kërkesën e shoqërisë rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a për ndryshimin e nivelit tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

Konstatoi se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a është licencuar me vendimin e KKRR nr. 16, datë 28.04.2023 "Për licencimin e shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Elbasan sh.a" për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe largimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a ka aplikuar pranë ERRU me shkresën nr. 2477 prot, datë 29.09.2023 me lëndë "Kërkesë për unifikim tarifash për tarifën fikse, tarifën volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura për

klientët e shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Elbasan sh.a" protokolluar me tonën nr. 336, datë 29.09.2023.

3. Bazuar në pikën 1, neni 10 i vendimit të KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, "*Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime*", aplikimi për ndryshimin e nivelit tarifor nga shoqëria pranë ERRU duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesa zyrtare drejtuar ERRU për ndryshimin e tarifave për shërbimet ujësjellës, kanalizime, dhe ITUN.
- b) Pasqyrat Financiare të vitit paraardhës certifikuar nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar;
- c) Plani 5 Vjeçar i Biznesit, ku të paraqitet edhe programi investimeve dhe aseteve të reja, i cili do të hartohet në përputhje me formatin e aprovuar në këtë metodologji nga ERRU, që është i detyrueshëm vetëm për grupin e shoqërive që tentojnë të mbulojnë 100% të Kostove Totale.
- d) Modeli i aplikimit për nivelin e ri tarifor. Të gjitha tabelat e modelit paraqiten të printuara dhe të firmosura nga shoqëria dhe sipas formatit excel të miratuar nga ERRU.
- e) Organigramë dhe përshkrimet e punës së stafit sipas pozicionit të tyre.
- f) Aktmarrëveshjet e kredisë midis shoqërisë dhe institucioneve kredi dhënëse, në rast se shoqëria është financuar me Hua dhe skema e planit mujor të shlyerjeve gjatë viteve të kaluara dhe viteve të ardhshme.
- g) Mendimin e Pushtetit Vendor për tarifën e propozuara të shprehura në vendimin përkatës dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut për legjitimitetin e tij.
- h) Vendimi i Këshillit të Administrimit për miratimin e tarifave të propozuara.
- i) Proces Verbal i Seancave Dëgjimore me Publikun sipas formatit të përcaktuar nga ERRU.
- j) Subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregullatore të tarifave të propozuara.
- k) Lejet ose Autorizimet për përdorimin e ujit për shoqëritë UK lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të shoqëruara me Marrëveshjen ndërmjet shoqërisë UK dhe KBU për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit në përputhje me VKM nr. 662, 2016 «Mbi tarifën e përdorimit të ujit»,
- l) Raport i detajuar për gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, në të cilën të përshkruhet inventari i aseteve në përdorim të shoqërisë me të dhëna teknike (përmasat, lloji i materialit, vitit të instalimit/ndërtimit), përfshirë dhe prioritetet për zëvendësimin e tyre. Ky material do të hartohet sipas formatit të përcaktuar nga ERRU.
- m) Relacion analitik ekonomik për vitin paraardhës, si dhe për periudhën rregullatore që kërkohet ndryshimi i tarifave, në të cilën shprehet qartë justifikimi dhe argumentet përkatëse dhe objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve të punës
- n) Në rast se shoqëria aplikon për tarifë shitje uji me shumicë, në kërkesën e saj për tarifa duhet të paraqesë: relacion teknik dhe ekonomik me llogaritjet e tarifës së shitjes së ujit

me shumicë, miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese si dhe akt marrëveshjet midis palëve shitës-blerës.

- o) Të ketë shlyer detyrimet për pagesën rregullatore sipas kontratës së nënshkruar midis ERRU dhe shoqërisë dhe në rast të detyrimeve të prapambetura të ketë shlyer sipas marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për shlyerjen me këste të tyre.
- p) Deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave sipas nenit 26 dhe nenit 46 të kësaj metodologjie.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria rajonale ujësjellës kanalizime Elbasan sh.a evidentohet se mungojnë këto dokumente:

- a) Mendimi i Pushtetit Vendor për tarifën e propozuara të shprehura në vendimin përkatës dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut për legjitimitetin e tij;
- b) Procesverbali i zhvillimit të Seancave Dëgjimore me Publikun;
- c) Subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregullatore të tarifave të propozuara;
- d) Lejet ose Autorizimet për përdorimin e ujit për shoqëritë UK lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të shoqëruara me Marrëveshjen ndërmjet shoqërisë UK dhe KBU;
- e) Përshkrimet e punës së stafit sipas pozicionit të tyre për secilën UK dhe për shoqërinë SKP;

5. Gjithashtu u evidentuan këto problematika në dokumentacionin shkresor të paraqitur:

- Plani i Biznesit 5 vjeçar nuk është i shoqëruar me vendim të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës apo Asambleja e Aksionarëve;
- Raport i gjendjes teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura është paraqitur në formë tabelare dhe mungon relacioni shpjegues sipas formatit të miratuar nga ERRU;
- Pasqyrat financiare për vitin 2022 për UK Librazhd janë të pa firmosura dhe të pa vulosura;

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a nuk e ka zhvilluar seancën dëgjimore me publikun në respektim të pikës 1, të nenit 13 “*Procedura dhe afatet e miratimit të tarifave*” të vendimit të KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a nuk ka respektuar akt marrëveshjen e nënshkruar me ERRU-në për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë rajonale UK Elbasan Sh.a nuk plotëson parashikimin e pikës 2 të nenit 10 të Vendimit nr. 539 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime”,

VENDOSI:

1. Të refuzojë aplikimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan për ndryshimin e nivelit tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.
2. Drejtoria Teknike Ekonomike ngarkohet të njoftojë shoqërinë rajonale ujësjetllës kanalizime Elbasan për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani